

LEBBEJKE ALLAHUMME LEBBEJK

LHSH i uron rrugë të mbarë të gjithë haxhinjve dhe lutje e haxh të pranuar tek Allahu i Madhëruar


Editorial / Islami nxit marrëdhëniet ndërnjerëzore

Nga Sokol KONDAKÇIU

Këtë shkrim po e nis me një shprehje, Këqë përdoret shpesh nga muslimanët: Feja është marrëdhënie ndërnjerëzore. Kjo shprehje edhe pse nuk është hadith ka një domethënie të vërtetë. I Dërguari Muhamed a.s. është dërguar mëshirë për të gjithë njerëzimin. Ai është dërguar tek ne për të na nxjerrë nga errësira në dritë, nga errësira e idhujtarisë për në dritën e besimit në një Zot të vetëm, nga errësira e padijes për në dritën e diturisë, nga errësira e padrejtësisë për në dritën e drejtësisë. Feja Islame është përshkruar nga Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëllartë si një fe e mesme, një fe e cila është sistem jetese, është më se e mjaftueshme për ndjekësit e saj, që të ngrihen e të lartësohen në majat më të larta të zhvillimit shpirtëror dhe atij material.

Kjo fe madhështore me këtë profet madhështor, i cili u dërgua për mbarë njerëzimin ka ardhur me këshilla, rregulla dhe parime të tilla, që kur muslimanët e parë i zbatuan dhe i bënë pjesë të pandarë të jetës së tyre arritën të ishin të parët në aspektin e zhvillimit shpirtëror dhe material. Ata ishin shembull i papërsëritshëm për historinë e njerëzimit, ngase nuk e shihnin të ndarë fenë nga çdo aspekt i jetës së tyre, dhe ky ishte sekreti që për një hark të shkurtër kohor u bënë faktor ndërkombëtar në kohën pas Profetit Muhamed a.s., duke mbizotëruar mbi një pjesë të madhe botës me perandorinë islame.

I Dërguari Muhamed a.s. erdhi që ta udhëheqë njerëzimin drejt besimit në një Zot të vetëm pa shok, erdhi që njerëzimin ta udhëheqë drejt moralit madhështor islam për të cilin Allahu i Madhëruar e ka lavdëruar në Kuran duke thënë: "Dhe ti (O Muhamed) je mbi një moral madhështor." (El Kalem 4). Ai u dërgua për të përsosur moralin njerëzor dhe është shprehur qartë kur ka thënë: "Unë nuk jam dërguar veçse për të përsosur moralin njerëzor." (Buhari). Përsosja e moralit njerëzor arrihet nëpërmjet obligimeve të ndryshme islame, të cilat janë adhurime, punë shpirtërore, që kanë në plan të parë bindjen ndaj Krijuesit Madhështor dhe gjithashtu ushtrimin e shpirtit (me këto ibadete), që e çojnë njeriun drejt përsosmërisë së kërkuar. Ajo që ndodh sot kur muslimanët e gjejnë veten në pozita të dobëta në një shoqëri ku nuk arrijnë të jenë faktor për ndryshim pozitiv vjen për shkak se ata nuk kanë një botëkuptim të plotë dhe të qartë për fenë islame dhe praktikimin e saj, si një sistem jetese ashtu siç edhe ai është. Ndoshta padashur me veprimet tona të përditshme e shohim fenë si të ndarë nga veprimtaria jonë, e cila në fakt duhet bazuar e gjitha mbi parimet drejta islame. Ndoshta një tregtar e shikon tregtinë e vet, si një aktivitet i cili ka rregulla të veçanta pa lidhje me Islamin të vendosura ato nga tregtarët e mëparshëm me gjithë të mirat dhe të keqijat që kanë ato rregulla. Ndoshta pa dashur ne mendojmë se Islami është vetëm në momentin kur ne jemi në xhami, kur e falim namazin, dhe kur dalim jashtë xhamisë mendojmë se bota



është një botë tjetër shumë më e egër nga ajo realja, dhe ne duhet të zbatojmë rregulla të tjera, ku pa dashur 'biem pre' e ayre që thonë se jeta është luftë.

Feja është sistem jetese dhe ajo përfshin të gjithë aktivitetin tonë njerëzor, si brenda, ashtu dhe jashtë xhamisë. Ajo ka ardhur që këtë jetë ta bëjë të lumtur nëpërmjet zbatimit dhe ndjekjes së parimeve të saj hyjnore. Vënia e saj në jetë fillon me daljen nga xhamia për tek vendi punës dhe i aktivitetit tonë ditor, ku kontakti me njerëzit është shumë i rëndësishëm, ku sjellja jonë dhe marrëdhëniet e krijuara me të tjerët është ajo çka tregon realisht se sa besimtarë jemi në të vërtetë. Mundësia e testimi të vetvetes për masën e besimit është më shumë jashtë xhamisë se sa brenda saj. Kur kthehemi në xhami për t'u falur në kulminojmë dhe kurorëzohim veprimtarinë tonë prej besimtari, i cili e ka të qartë se obligimet nuk janë finalja dhe objektivi, ashtu siç nuk mund të ketë nga ana tjetër musliman të mirë praktik në marrëdhëniet ndërnjerëzore, larg obligimeve fetare dhe parimeve të drejta islame. Nuk mund të kuptohet Islami si teori pa praktikë. Nuk mund të jetë një musliman i mirë nëse nuk është një njeri i mirë zbatues i parimeve të shenjta islame, nuk mund të jetë një musliman i mirë nëse nuk është i edukuar dhe i sjellshëm me njerëzit që e rrethojnë, edhe nëse falet, edhe nëse agjëron. I Dërguari i Allahut ka treguar për një grua, se do të jetë prej banorëve të xhehenemit ngase sillej keq me fqinjët e saj, edhe pse falej dhe agjëronte, kurse nga ana tjetër ka thënë për një grua tjetër se do të jetë nga banorët e xhehenit vetëm se ajo sillej mirë

me fqinjët e saj. (Ibn Hibani) Obligimet fetare, si namazi, agjërimi e kështu me radhë, përveç anës urdhërore hyjnore, së cilës i përgjigjet bindja njerëzore ka anën edukative ushtrimore, si ushqim i vazhdueshëm për shpirtin, ku nëse nuk zbatohen mirë rregullat dhe nuk u jepet haku i duhur, ato thjesht kthehen në ushtrime fizike pa vlerë e pa shpërblim. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: "Në të vërtetë falja e namazit të ndalon nga të këqijat dhe të ndaluarat..." (El Ankebut 45) "Do të ketë njerëz që kanë punuar e lodhur shumë, por që do të hidhen në zjarrin e xhehenemit." (El Gashijeh 3-4), si dhe thënia e profetit Muhamed a.s. për agjërimin: "Ndoshta prej agjëruesve ka prej atyre, që nga agjërimi nuk fitojnë veçse urinë dhe etjen dhe falësi i namazit të natës, veçse pagjumësinë." (Ibn Maxheh). Nga këtu kuptojmë se Feja Islame nuk është teori apo mësim përmendësh i parimeve islame, por ai është sistem jetese i praktikueshëm dhe këtë e kanë dëshmuar

brezat e parë. Ne muslimanët e sotëm nëse duam të jemi muslimanë të vërtetë duhet të rikonceptojmë në mënyrë të drejtë edhe një herë fenë islame në tërësi me parimet e saj hyjnore, dhe të mendojmë t'i japim përparësi gërshetimit midis obligimeve dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore në jetën e përditshme, sepse nuk ka vetëm Islam teorik dhe Islam praktik, por ka Islam të vërtetë me parime hyjnore bazuar në Kuran dhe traditën e bukur profetike, të cilat marrin jetë dhe shpirt, vetëm kur ne i zbatojmë dhe i zbresim ato në realitetin ku jetojmë. Feja është marrëdhënie ndërnjerëzore, feja është praktikë, sjellja dhe morali i shëndoshë është tregues për një besim të lartë, dhe morali dhe sjellja e ulët tregojnë për një besim të dobët. Në fund po e mbyll këtë shkrim me fjalën e imam Malikut, i cili ka thënë: "Fundi i këtij ymeti do të ndreqet me çka u ndreqën të parët e tij". Falënderimi i takon Zotit të botëve.

Fq 5 / Bota Muslimane i kërkon OKB-së ta deklarojë islamofobinë si krim

Nga Ferhan IKBAL

Fq 6 / Rënia e bllokut komunist dhe elita boshnjake

Nga Faik MIFTARI

Fq 7 / Udhëzuesi i haxhiut

Fetva / Asambleja e Juristëve Muslimanë të Amerikës

Puna në fushën e inxhinierisë dhe rastet kur përzihet hallalli me haramin

-Nuk lejohet që pronarët myslimanë, të studiove që merren me hartimin e projekteve ose firmave që merren me ndërtime, të projektojnë ose ndërtojnë godina, të cilat ngrihen për të zhvilluar aktivitete të ndaluara nga ana fetare, si p.sh.: bare, salla bixhozi, dyqane pijesh alkoolike, objekte kulti ku zhvillohen adhurime shirku etj. Gjithashtu nuk lejohet që muslimanët marrin pjesë në sipërmarrje që kanë të tilla gjëra, këtu përjashtohet rasti kur kanë një ortak jomusliman, ku është ai i cili e merr këtë sipërmarrje si pronë dhe administrim dhe vetëm ai fiton apo humb nga kjo sipërmarrje. Tolerohen rastet e rralla dhe të tepër të kufizuara të elementëve të ndaluar që kanë këto sipërmarrje, nëse për to nuk gjendet dikush tjetër jomusliman që të merret me të...

-Nëse godina është ngritur për një veprimtari që si bazë ka një aktivitet të lejuar fetarisht, por në të përzihen edhe pak gjëra të ndaluara, jo si elementë bazë të saj, por si elementë dytësor, atëherë kjo gjë tolerohet, sepse këto gjëra janë mjaft të përhapura dhe të pashmangshme, duke mos lënë këtu pa përmendur nevojën për punë dhe vështirësinë për të gjetur në këto vende hapësira pune tërësisht hallall në këtë fushë.

-Lejohet të punohet në kompanitë që merren me projektimin e godinave apo ndërtimeve të tyre edhe nëse në punët e tyre ka përzjerje të hallallit me haramin, me kusht që ai që punon në këto kompani tu shmanget punëve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me aktivitetin e ndaluar fetarisht, siç janë projektimi dhe ndërtimi i bareve, kazinove, objekteve kulti shirku etj.

-Nëse punonjësit mysliman në këto kompani i ngarkohet si punë projektimi apo ndërtimi i godinave që zhvillojnë aktivitet të ndaluar dhe ai e ka të pamundur t'i shmanget kësaj pune e ndërkohë nuk ka gjetur alternativë tjetër ku të punoj, tolerohet për të që të merret me këtë punë për shkak të nevojës, nëse kjo punë nuk është e shpeshë, por me raste të rralla. Në rast se kjo veprimtari ku përfshihen punë të ndaluara është e shpeshë dhe ky punonjësi e ka të pamundur tu shmanget atyre, e ka si detyrë të kërkojë një punë tjetër më të pastër për të ardhurat e tij dhe më të kënaqshme për Zotin, kështu që ky njeri e ka si detyrë që në këtë periudhë transitorë të pastrojë pasurinë e tij nga

të ardhurat që përfitohen nga aktiviteti i ndaluar fetarisht.

Burimi: <http://amjaonline.org/2007/11/decisions-and-recommendations-of-amjas-fifth-annual-convention/>

Rreth punës në disa veprimtari tregtare

1. Hapja e filialeve të dyqaneve që shesin ushqime që përmbajnë edhe haram.

-Nuk lejohet për myslimanin të kërkojë hapjen e një filiali tregtar, për shitjen e mallrave ushqimore që përmbajnë ushqime ose pije të ndaluara fetarisht, vetëm në rast se ai si filial kufizohet në shitjen e ushqimeve të lejuara.

- Nëse kompanitë që japin të drejtën e të qenit filial i tyre nuk pranojnë të japin të drejtën për shitjen e vetëm disa prej mallrave të tyre, por në këtë rast është e mundur që këto prodhime të ndaluara fetarisht t'i marrë përsipër një ortak jomusliman, i cili nuk i konsideron ato si të ndaluara, ne nuk shohim ndonjë ndalesë në këtë drejtim, por me kusht që vetëm ortakut jomusliman t'i takojë pasuria dhe administrimi i këtij lloji malli, po ashtu edhe fitimi dhe humbja, gjithashtu duhet të vendoset një ndarje fizike e dukshme ndërmjet këtyre dy llojve mallrash, për të shmangur kështu konfuzionin dhe konfliktin.

-Nëse dikush bëhet pjesë e një kontrate tregtie, për të qenë filial i një kompanie e cila shumicën e mallrave i ka hallall, por që shet edhe ushqime dhe pije të ndaluara fetarisht, jemi të mendimit se kontrata për të qenë filial mund të vazhdohet nëse respektohen këto kritere:

1. Aktiviteti i këtij filiali nuk duhet të përfshihet në tregtimin e pijeve alkoolike qoftë kjo edhe në sasi të vogla.

2. Të bëhen përpjekje maksimale me kompaninë pronare që të lirojë këtë filial nga detyrimi për të tregtuar mallra haram.

3. Të pakësojë sa të jetë e mundur tregtimin dhe promovimin e mallrave haram.

4. Të jenë jomusliman ata që kanë kontakt dhe merren me përgatitjen e shitjes e mallit haram.

5. Të largohet nga pasuria e fituar nga shitja e mallit haram shuma përkatëse dhe të shpenzohet në çështje bamirësie.

2. Bankomatet

- Lejohet dhënia me qira e vendit për vendosjen e bankomateve ATM, sepse këto aparatura në pjesën dërmuese të tyre përdoren për tërheqjen e shpejtë të parave nga numrat e llogarive personale.

- Lejohet për tregtarin që koston e mallit të shitur ndaj klientëve të tij ta

marrë nëpërmjet kartave të kreditit, sepse kostoja e mallit e marrë në këtë mënyrë është e lejuar.

3. Puna në dyqanet e argjendarisë

I lejohet myslimanit që të investojë ose punojë në dyqanet e argjendarisë, me kusht që shkëmbimi që duhet të bëhet dorë më dorë të respektohet, si dhe bizhuteritë që shiten të mos përmbajnë statuja ose simbole të feve dhe besimeve që bien ndesh me Islamin.

4. Puna në dyqanet që ndodhen në stacionet e karburantit

Nuk i lejohet myslimanit i cili ka investuar ose punon në dyqanet që ndodhen pranë stacioneve të karburantit ose në vende të tjera, të merret me shitje të biletave të lotarive apo çdo lloji malli haram që shitet zakonisht nëpër këto vende. Ndërsa për sa i përket dhënies me qira të këtyre dyqaneve, që ndodhen pranë stacioneve të karburantit, personave të cilët shesin mallra që në shumicën e tyre janë të lejuara, por kanë edhe disa mallra haram, nuk mendojmë se kjo kontratë është e ndaluar fetarisht, sepse kontrata është nënshkruar për një shërbim të lejuar, ndërsa gjynahun në këtë rast për sendet haram e mbart vetëm qiramarrësi.

Burimi: <http://amjaonline.org/2007/11/decisions-and-recommendations-of-amjas-fifth-annual-convention/>

Puna në kompanitë e sigurimit

- Sigurimi është një nga çështjet bashkëkohore për të cilin kanë folur dijetarët e sotëm të fetvasë, si në nivel individual ashtu edhe në nivel institucionesh dhe akademish.

- Sigurimi është i formave të ndryshme: disa nga këto forma lejohen dhe disa janë të ndalura, siç ka edhe forma të tjera që janë objekt i opinionëve të ndryshme (ixhtihadeve) ndërmjet dijetarëve.

- Gjykimi në lidhje me punën në këto institucione lidhet me gjykimin që marrin vetë këto kontrata sigurimi. Kontratat që gjykohen si të vlefshme (nga ana fetare), puna në këto institucione lejohet, ndërsa ato që nuk konsiderohen të tilla, puna në to nuk lejohet, siç nuk lejohet po ashtu edhe mbështetja e tyre.

- Në themel sigurimi (financiar) është një sistem i bazuar në ofrimin e një shërbimi të dobishëm, të solidaritetit dhe bamirësisë. Me këtë kuptim dhe në këtë kontekst, ai është një nga vlerat themelore islame, nëse i përmbahet në organizim, kontrata dhe investim të fondeve të tij rregullave të Sheriatit. Në fakt nuk do të ishte e tepruar të thuhet se, nëse sigurimi zhvillohet në këtë kontekst duke pasur parasysh edhe realitetin ku jetojmë, ai të jetë një detyrim komunitar (fard kifajeh).

- Sot në kohën tonë sistemet e sigurimit dhe kontratat e tyre janë të llojeve të ndryshme, kemi kontrata

sigurimi të karakterit tregtar, shoqëror dhe të bashkëpunimit reciprok (mutual insurance). Për çdo njërin prej tyre ka një gjykim të veçantë.

- Gjykimi bazë për sa i përket sigurimit me karakter tregtar, i rregulluar nga ligjet e sigurimit tregtar dhe i praktikuar nga ofruesit e sigurimeve tregtare (ku në këtë rast kompania e sigurimit është partner real në kontratë dhe është e detyruar të paguajë personin e siguruar në rast se ndodh dëmi i objektit të siguruar, kundrejt një pagese fikse nga i siguruari gjatë gjithë periudhës së sigurimit) është se të tilla kontrata janë të pavlefshme (fetarisht), sepse ato ndërtohen mbi diçka të pasigurt dhe elementë të panjohur (që i përkasin të ardhmes garar uel xehale) si dhe elementë të tjerë të pavlefshëm. Të tilla sigurime nuk lejohen, përveç rasteve kur të detyron ligji apo për nevoja jetësore (p.sh. mbajtja e makinës) të cilat marrin gjykim të ngjashëm me domosdoshmërinë. Të punosh në marketingun e këtyre kontratave apo tu japësh atyre asistencë është e palejuar, me përjashtim të rasteve të domosdoshme apo të një nevoje të përgjithshme, raste këto që marrin të njëjtin gjykim si domosdoshmëria. Ai i cili detyrohet të punojë në këtë sektor duhet ketë gjithmonë parasysh synimin për tu larguar nga kjo punë në momentin më të parë që i mundësohet kjo gjë.

- Për sa i përket sigurimeve shoqërore, që nuk kanë si synim fitimin, por kanë si qëllim përkrahjen sociale apo shëndetësore për përfituesit dhe janë nën vartësi –zakonisht- të shtetit apo të kompanive dhe institucioneve publike, të cilat operojnë duke mbajtur një përqindje të caktuar nga rroga njerëzve të punësuar apo edhe duke i shtuar ose jo një përqindje nga ana e tyre kësaj rezerve, gjatë gjithë kohës që ky njeri është në marrëdhënie pune, atëherë kjo është e lejuar. Lejohet të përfitohet nga ky lloji sigurimi si dhe të punosh në institucionet që merren me të ose me marketingun e tij, sepse në tërësi ky aktivitet bazohet mbi diçka të lejuar. Por duhet pasur parasysh se në tilla raste duhen shmangur praktika të tilla të palejuara, si p.sh. investimi i këtyre fondeve në projekte kreditore (përfitim me kamatë) dhe të ngjashme me të.

- Siguracioni Islam (që i ngjan në disa aspekte sigurimit të bashkëpunimit reciprok apo kooperativë) bazohet mbi dhurimin, bashkëpunimin dhe përfitimin e ndërsjellët. Kompania në këtë mes luan rolin e agjentit administrues të proceseve të sigurimit dhe të sipërmarrësit të fondeve të tij. Kjo është një kontratë e lejuar nga ana fetare ndaj dhe lejohet të përfitosh prej saj dhe të punosh në institucionet që merren me të, nëse ato respektojnë të gjitha rregullat e tjera të fesë në lidhje me investimin e fondeve të sigurimit.

Burimi: <http://amjaonline.org/2007/11/decisions-and-recommendations-of-amjas-fifth-annual-convention/>

Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:
Justinian Topulli
Genc Plumbi
Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës:
Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Oazi i shpirtit / Të mësojmë të bëjmë durim

Përgatiti: Bledar HAXHIU

Nuk ka dyshim se ne si krijesa ka- lojmë një jetë të mbushur me ndodhi dhe situata ku shumë prej të cilave janë të paparashikueshme, sepse ne nuk e dimë gjatë. Shpesh herë ndodhemi keq, herë të tjera na godasin fatkeqësi, si dhe vazhdimisht kemi nevojë për diçka e cila do të na ndihmojë të ecim drejt Allahut; të gjitha këto kanë nevojë për një cilësi të madhe e cila duhet të jetë prezent tek çdo njëri prej nesh, dhe kjo cilësi është durimi.

Allahu na ka treguar për këtë realitet, na ka bërë të qartë se sa kemi nevojë për durim dhe gjërat me të cilat ne do të përballlemi: "Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve". Durimi është pjesë e besimit tonë, sepse me anë të tij ne i përmbahemi urdhrave të Allahut, kufizohemi nga ndalesat e Tij dhe i bëjmë ballë të papriturave të kaderit. Allahu për shkak të kësaj vlere që ka sabri dhe domosdoshmërisë së tij na drejtohet e thotë: "O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit." Nëse të godet një dhimbje, mos mendo se je i vetëm, ti sigurisht që ke ku të marrësh shembull, nëse sprovohesh me fatkeqësi, do të gesh histori të atilla që do të japin zemër dhe kurajë për të duruar. Kurrë mos mendo se durimi është cilësi e cila kërkohet vetëm prej teje; jo nuk është kështu, të gjithë duhet të durojmë, madje kjo gjë është kërkuar edhe njeriut dhe krijesës më të lartë Muhamedit -alejhi selatu ue selam: "Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur". Nëse vëlla dhe ti o motër ke marrë përsipër të ftosh njerëzit në fenë e Allahut, por ke hasur në mosdëgjim, moskokëçarje apo dhe injorim, të them duro, bëj pak durim nga durimi i Nuhut -alejhi selam, i cili plot 950 vite duroi arrogancën, sharjet dhe ofendimet e popullit të tij. "Ai tha: "O Zoti im, unë e thirra vërtet popul-


lin tim natë e ditë, por thirrja ime edhe më tepër i largoi (nga e vërteta). Sa herë, që i thirrja për t'i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim). Pastaj i thirra me zë të lartë. Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi". Por kush ishte përfundimi i këtij durimi kaq të gjatë: "Kështu, Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të në barkën plot, kurse të tjerët që mbetën pas, i fundosëm". Nëse ke humbur vendin e punës, të humbi pasuria apo një sëmundje e vështirë ka kapluar trupin tënd, të them duro, bëj pak durim nga durimi i Ejubit të cilit i humbi gjithçka që kishte, fëmijë, pasuri e pozitë. E kur Allahu pa ke ai durim e vendosmëri, iu përgjigj. "(Kujtoje) Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: "Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!" Ne iu përgjigëm atij, ia larguam mjerimin që kishte dhe ia kthyem familjen të dyfishuar në numër. (Këtë e bëmë) nga mëshira Jonë dhe që të jetë përkujtesë për ata që Na adhurojnë." Nëse përballësh me probleme financiare, vuan në brendësinë tënde kur sheh se fëmijët e tu nuk ushqehen si të tjerët, duro; bëj pak durim nga durimi i njeriut më të mirë të cilit i bën embargo dhe e izoluan për tre vjet me radhë aq sa njerëzit që ishin me të, të rritur e fëmijë hanin edhe gjethe pemësh në mesin e shkretëtirës. Bëj pak nga durimi i Profetit tënd në shtëpinë e të cilit kishte raste që për një muaj rresht nuk ndizej zjarri, e ushqimi i të cilit ishin hurmat dhe uji. Nëse njerëzit e tu më të shtrenjtë të kthejnë krahët, jo për ndonjë të keqe që mund ta kesh bërë, ti sërish bëj durim, bëj pak durim nga durimi i Jusufit -alejhi selam- të cilin vëllezërit e hodhën në pus dhe e shitën si skllav, i cili qëndroi në burg për vite me radhë thjesht për një akuzë të rreme e jo për ndonjë krim që ai e kishte bërë. Bëj durim dhe mbështetu tek Allahu, se Ai padyshim do të nxjerrë ngadhënjimtarë ashtu sikur nxori dhe Jusufin. Nëse të humb i afërmi apo drita e zemrës tënde -fëmija yt- bëj durim; bëj pak durim nga durimi i Jakubit -alejhi se-

lam- kur i humbi biri i tij, edhe në këtë gjendje ai tha: "Unë po bëj durim Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni në nderin tënd, apo familjes tënde, bëj durim; bëj pak durim nga durimi i nënës së besimtarëve Aishes të cilën hipokritët e akuzuan për gjëra të pahijshme. Bëj durim dhe mbështetu Allahut, e të jesh i sigurt se Allahu do ta nxjerrë të vërtetën në shesh, ashtu sikur e nxori edhe për Aishen. Nëse familja të braktis për shkak të fesë tënde, për shkak se ti kërkon të jesh rob i denjë i Allahut, bëj durim; bëj pak durim nga durimi i Mus'ab ibn Umejrit, apo Umu Habibes vajzës së Ebu Sufjanit, mos u thyej, ec përpara e të jesh i sigurt se ke për të arritur atë që ata arritën. Nëse dikush kërkon të vër në provë besimin tënd, apo kërkon që të shuaj besimin tonë, le të bëjmë durim e ta përballojmë këtë situatë me iman e bindje në ndihmën e Allahut. Të bëjmë durim siç bënë muslimanët e parë, nëna e Jasirit dhe babai i tij; bëni

pak durim nga durimi i Bilalit apo siç bëri Profeti me të gjithë muslimanët e parë. Të jesh i sigurt se çdo gjë që të ndodhë, edhe sikur ti më të mos ekzistosh, kjo është fe e Allahut e Ai ka vendosur t'i japë ngadhënjimin asaj. "O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!"

II

Le të bëjmë durim sepse Profeti -salallahu alejhi ue selem- ka thënë: "Durimi është gjysma e besimit". "Durimi është dritë". "Nuk i është dhënë dikujt dhuratë më e mirë se durimi". Le të bëjmë durim se Allahu i do durimtarët dhe është me ta, madje Ai për ta jep shpërblim pa masë. "Përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!" Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!"



DUAJA E PEJGAMBERIT, sal-lallahu alejhi ue selem, PËR UMETIN DHE TË QARËT E TIJ NGA DHEMBSHURIA PËR TA

Abdullah Ibën Amër ibën Asi na Apërcjell, se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem, e lexoi Fjalën e Allahut, që tregon për Ibrahimin, alejhi selam, ku thuhet: "Zoti im! Ata vërtet i shmangin (nga rruga e drejtë) shumë njerëz. E kush më respekton mua, ai është i imi (në fe), e kush më kundërshton mua, atëherë Ti je që fal dhe që mëshiron." (Ibrahim: 36), kurse Isa, alejhi selam, ka thënë: "Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu, e nëse ua fal atyre, Ti je i Gjithëfuqishmi, i Urti." (Maide: 118). Atëherë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem, ngriti duart e tij dhe u lut: "O Zot, umeti im, umeti im..." dhe pastaj filloi të qajë. Allahu pastaj tha: "O Xhibril, shko tek

Muhamedi dhe pyete pse qan,- edhe pse Allahu është i Gjithëdijshëm për të. Xhibrili erdhi dhe e pyeti. Pastaj i tregoi Allahut edhe pse Ai e dinte shkakun. Zoti ja ktheu: "O Xhibril, shko tek Muhamedi dhe thuaji: "O Muhamed... Ne do të kënaqim (me gjykimin, sjelljen, faljen tonë, etj.) në umetin tënd dhe assesi nuk do të mërzisim tek ata."

Këtë hadith e shënon vetëm imam Muslimi me nr: 497.

Komentimi:

Në këtë hadith përmenden fjalët e dy pejgambereve të Allahut, Ibrahimit dhe Isait, të cilët u lutën për umetet e tyre.

Hadithi përmbledh në vetvete shumë dobi të rëndësishme:

1-Dhembshuria e madhe që Pejgamberi Muhamed, sal-lallahu alejhi ue selem, kishte për umetin e tij. Interesimi i tij për umetin, për sjelljen e mirësive deri tek ta, etj.

2-Ngritja e duarve gjatë bërjes së lutjeve-duave.

3-Përgëzimi i madh, që i bëri Allahu këtij umeti, duke treguar se Allahu do t'u japë aq shumë mirësi sa Muhamedi, sal-lallahu alejhi ue selem, do të kënaqet me këtë gjë. Ky hadith që përmend këtë pjesë të fundit të tij është prej haditheve më shpresëdhënëse për Umetin Islam.

4-Hadithi tregon pozitën e lartë që ka Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem, tek Zoti.

5- Dashuria dhe butësia e madhe e Allahut, që ka për Muhamedin, sal-lallahu alejhi ue selem, pasi ka dëshirë që të dërguarin e Tij ta kënaqë, ashtu si është më e mira.

6- Dërgimi i Xhibrilit, alejhi selam, për ta pyetur tregon se Allahu dëshiron me çdo kusht ta gëzojë Pejgamberin tonë, sal-lallahu alejhi ue selem, duke i dhuruar gjëra me të cilat ai gëzohet.

7- Ky hadith është i ngjashëm me Fjalën e Allahut në Kuran: "E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh." (Duha: 5).

(Sahihu Muslim me koment të Neveviut. Vëllimi 3, fq. 73-74. Shtëpia botuese: "Dar Marife-Beirut-botimi 7, viti 2000")

Përshtati: Lulzim Memet Susuri

Opinion / A është feja opium për masat?

Eseoi: Enklid PELARI

Në artin e drejtimit të masave, një ndër modalitetet më të përdorura –dhe që përdoret akoma- është: “Sulmi ndaj rivalit (armikut) politik si propaganda më efikase për të fituar hegjemoninë ndaj rivalëve politike. Kjo ndodh sepse duke e përdorur tjetrin si objekt sulmi, akuzuesi synon të ulë vlerat e subjektit të sulmuar dhe njëkohësisht me anë të efektit rikoshet ai thur lavde ndaj figurës së tij duke e ngritur veten në pedestal në mënyrë indirekte”. Kjo gjë krijon tek masat impaktin psikologjik të autoritetit të vlerave që lufton për t'i shpëtuar ata nga “të ligat” që i kanosen, çka i nënshton edhe më shumë masat dhe krijon bazë mbështetje prej tyre. Njëkohësisht kështu reduktohen dhe demoralizohen edhe më shumë kundërshtarët politik. Prandaj gjejmë në histori se çdo diktator e kishte –të nevojshme- një armik të jashtëm dhe të brendshëm. Përveç armikut të jashtëm (imperialistëve perëndimor), ndër armiqtë kryesor të brendshëm për komunistët ishte edhe religjioni si doza më e keqe “opiumale” për popullin. Në fakt, ideologjia komuniste nuk synonte në vetvete borgjezinë dhe elitat e shoqërisë -ajo për ta ishte një mjet për të arritur qëllimin- sesa synonte ideologjinë e djathtë, e cila në vetvete origjinën e ka tek religjioni: “Zoti i trashëgoi njeriut tokën dhe trashëgimia (pronësia) është e shenjtë.” Komunistët e dinin se nga ky nocion lindte më pas e drejta e pronës private, renta e tokës, sipërmarrjes, tregtisë, industrisë dhe industrializimit dhe në fund ndarja e klasave. Po të vëmë re ideologjia komuniste kundërshtonte me forcë të gjitha këto hallka të zhvillimit shoqëror. Pas shekujsh të

edukimit të shoqërisë njerëzore me idenë e “pronarit dhe punëtorit”, apo “borgjezit dhe proletarit”, Marks dhe Engelsi -ndryshe nga disa komunistë të tjerët që e kërkuan këtë ndryshim me arsimim- ngulmuan që me dhunën e revoltës proletare të rrëzohej borgjezia dhe uzurpatorët që përndanin dhe shpërndanin në mënyrë të pa drejtë të mirën publike. Sipas disa historianëve, ideja se mjeti justifikon qëllimin, u përdor nga komunistët, sepse ata e dinin shumë mirë që lufta ideologjike e nisur prej tyre ishte e humbur që në fillim dhe në mungesë të aftësive dhe fuqive dogmatizuese ata u strehuan tek dhuna. Duke ditur këtë, hartuesit e propagandës komuniste në përpjekje për të neutralizuar ideologjitë fetare u përqendruan në tre pseudo-teza kryesore: “Komunizmi si evolucion shkencor i njerëzimit, Feja (këtu përfshiheshin edhe ideologjitë e djathta) si prapambetje e njerëzimit dhe Objektet e kultit si burime indoktrinimi të pa drejtë”.

• Për të sendërtuar të parën ata u bazuan te teoritë darviniane, sidomos ajo e evolucionit. Pikë së pari, siç dihet gjerësisht edhe tek studiuesit e shkencave ekzakte çdo teori mund të ndryshojë në çdo kohë. Pra, vet teoria është një tezë e ngritur pas shumë eksperimentesh dhe konkluzionesh të një grupi studiesh, e cila mund të hidhet poshtë në çdo kohë nga një zbulim i ri. Fjala bie në Amerikë, një tjetër teori ecën në mënyrë paralele me teorinë e Darvinit, e cila e hedh poshtë teorinë e evolucionit me fakte shkencore. Ajo quhet teoria e kreacionizmit. Edhe sikur ta merrnim të mirëqenë teorinë e Darvinit si teori dominuese (në

botën e civilizuar ajo trajtohet si çdo teori tjetër) prapë se prapë në vetvete një teori nuk disponon kapital legjitimues për përdorimin e dhunës dhe forcës nga aparati shtetëror. Këtu komunistët nuk dalluan nga religjiozët e mesjetës që shpallnin luftë për hir të idealit fetar.

• Për pikën e dytë, ata emetuan idenë se feja është regres për njerëzimin. Në fakt komunistët nuk e kuptuan se prapambetja apo progresi, s'ka të bëjë me moralin apo fenë, por ka të bëjë pikërisht me shfrytëzimin e natyrës (materies) në dobi të racës sonë. Pra ishte revolucioni industrial ai që po e çonte njerëzimin përpara, ndërkohë që ky zhvillim ishte i pranueshëm edhe nga feja. Komunistët ishin ata që në këtë fushë e çuan racën tonë të paktën gjysmë shekulli pas me teoritë e tyre se: “Shtimi makinerive dhe pajisjeve do rrisë papunësinë” apo me teorinë tjetër se: “Shtimi kapitalistëve do t'i çojë ata në luftë mes vetes për të mbijetuar”. Kështu ata legjitimonin monopolin dhe centralizimin e ekonomisë. Edhe kjo tezë bëri që kudo në botë vendet komuniste të prodhonin skarcitete dhe mallra pa ndonjë vlerë të brendshme, mallra që ishin monopol dhe subvencionoheshin dëshpërimisht nga shteti, ndryshe nga teoritë e djathta ku nxitet konkurrenca e lirë dhe e ndershme me anë të avantazheve krahasuese dhe konkurse, të cilat në vetvete nxisin rritjen e kualitetit dhe ekuilibrojnë çmimin e mallrave në pikën optimale të tregut.

• Për sa i përket objekteve të kulteve ata i konvertuan kishat dhe xhamitë në qendra kulturore dhe muze arti, të cilat në vetvete ishin një propagandë e pastër komuniste. Po të flisnim me gjuhën e tyre, media dhe

arti në atë kohë ishin konvertuar në doza morfinogjene për të qetësuar dhimbjet e masës. Të gjitha “gjetjet” në fakt hedhin dritë mbi “impotencën ideologjike” të ideatorëve të komunizmit. Sepse, pikë së pari partia-shtet kudo në botë, në përpjekje për të luftuar klasat krijoi pa dashje klasën më të madhe dhe më të padrejtë sunduese, atë të qeverisë që grabiti dhe mori në dorë çdo gjë. Pikë së dyti në tentativë për të luftuar fenë, komunizmi u ndërtua mbi baza fetare, si ndihmesa e të varfrit duke e marrë pasurinë nga të pasurit dhe më pas shpërndarja e saj tek të varfrit. U prishën kultet fetare, por u ndërtua kudo në vend kultit i Diktatorit. U përhapën thënie pothuajse teologjike si: “Degjenerimi moral sjell degjenerim politik”, “degjenerimi familjar si qelizë kryesore e shoqërisë shkatërron shoqërinë” etj. Dëmet kryesore të komunizmit vazhdojmë t'i vuajmë edhe sot. Ato përhapën te masa idenë se ligjin e bën më i forti, duke shtypur kështu instinktin e dallimit midis asaj se çka është e drejtë dhe çka jo. Po ashtu njerëzit u brumosën me idenë e legjitimitit të forcës dhe shfuqizimit të drejtësisë prej saj. Kjo gjë vazhdon të mbajë në këmbë te ne kulturën e pandëshkueshmërisë. Gjithashtu akoma nuk na është hequr nga mendja koncepti organik që kemi për shtetin dhe që vet shteti ka ndaj vetes dhe që në vetvete nuk po lejon përhapjen e konceptit mekanicist ku shteti shikohet si një mjet që është në shërbim absolut të qytetarit. Ndër këto pasoja, nuk bën dallim as religjioni të cilin akoma e shohim si “opiumin” e dëmshëm të shoqërisë, ndërkohë që “Opiumi” i vërtetë akoma s'na ka dalë.

Përkatësi ndaj kombit apo ndaj parimit?

Nga: Dr. Xhafer Shejh Idris

Duke bërë fushatë elektorale, që të bëhen presidentë apo të fitojnë një vend në parlament si deputet, disa njerëz duke lavdëruar veten thonë se: “ata nuk i përkasin ndonjë grupimi apo pikëpamje të caktuar” dhe nëse ata zgjidhen do t'i përkushtohen interesave të vendit dhe askujt tjetër... Kjo propagandë bazohet në supozimin se, ekziston kontradiktë në mes përkatësisë ndaj atdheut dhe përkatësisë ndaj pikëpamjes ose besimit të caktuar që dikush ndjek, cili do qoftë ai. Ky supozim nuk është i saktë.

Së pari: përkatësia ndaj atdheut detyrimisht të shpie drejt përkatësisë ndaj një doktrine të caktuar, të cilën njeriu nganjëherë nuk e kupton. Nëse para dikujt do të paraqitet një problem që kërkon zgjidhje në interes të atdheut të tij, cila do të jetë mënyra sesi ai do të mendoj për zgjidhjen e problemit?

Së dyti: përkatësia ndaj një pikëpamje apo besimi të caktuar nuk do të thotë detyrimisht se njeriu është fanatik, i paarsyeshëm dhe i njëanshëm, por ndoshta vetë pikëpamja të cilën ai ndjek fton te morali i lartë, mes të cilave edhe te sinqeriteti, besa dhe paanësia. Islami që herët është karakterizuar nga diçka e tillë; një njeri që njihej si musliman vodhi një mburojë dhe e fshehu atë te një hebre ku edhe u gjet, por ndërkohë vjedhësi u betua se nuk e kishte vjedhur ai mburojën dhe

fisi i tij kërkoi nga Profeti (alejhi salatu ue selam) që ai t'i dilte atij në mbrojtje dhe ta shfajësonte atë, por Allahu i Lartësuar zbriti fjalën e Tij: “Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykohej ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!” (en-Nisa:105) Kurani shfajësoi hebreun në këtë rast. Nuk e di se cili do të ishte në këtë rast qëndrimi dhe sjellja e atyre që atdheun e vënë mbi çdo gjë, qoftë edhe mbi moralin?

Së treti: përkatësia ndaj një pikëpamje ose besimi të caktuar nuk do të thotë detyrimisht mohim i atdheut, përkundrazi njeriu mund t'i përkasë një besimi të caktuar dhe përsëri të ketë mall të madh për atdheun e tij, vetë Profeti (alejhi salatu ue selam) kur idhujtarët e Mekës e detyruan të emigrojë prej saj tha: “Sa vend i mirë që ti je dhe sa i dashur për mua! Nëse banorët e tu nuk do të më kishin nxjerrë nuk do të kisha banuar askund tjetër.”

Kështu sillëshin edhe shokët e Profetit (alejhi salatu ue selam) duke shprehur mallin e tyre për atdheun, si p.sh. fjalët e Bilalit (radijallahu anhu): “Ah sikur ta dija nëse do të qëndroja një natë mes luginës dhe përreth meje idhëri dhe xhelili! [Lloje barishtesh që rriten në Mekë.] A do të mund një ditë të vija tek uji i Mexhenes dhe a do të më shfaqej Shame dhe Tufejl! [Mexhene është emër vendi pranë Mekës, ndërsa Shame dhe Tufejl emra malesh.]”

Së katërti: shndërrimi i dashurisë për atdheun në doktrinë që qëndron mbi çdo

besim dhe pikëpamje mund ta çojë njeriun që beson në këtë gjë në urrejtje të çdo besimi dhe pikëpamje që ai mendon se bie ndesh me besimin e tij. Ky njeri shndërrohet në një Hitler, armik me të gjithë ata që nuk

besojnë atë që ai beson dhe në luftë kundra tyre me të gjitha mjetet e mundshme.

Burimi: revista “El-Bejan” nr.300, Shaban 1433h./Korrik 2012 e.s.

Peace TV Albanian me studio të reja regjistrimi edhe në Tiranë

Para pak ditësh në një atmosferë shumë vëllazërore u përruan për herë të parë studiot e regjistrimit të Peace TV Albanian në Tiranë. Fjalën përshëndetëse të rastit e mbajti hoxhë Ahmed Kalaja, që me pak fjalë u shpjegoi të pranishmëve synimet dhe objektivat e këtyre studiove, të cilat do të jenë krejtësisht të hapura në shërbim të të gjithë hoxhallarëve. Ai përfitoi nga rasti që t'i ftojë të gjithë hoxhallarët të bëhen pjesë e këtij projekti të madh mediatik. Në fjalën e tij ai theksoi rëndësinë e këtyre studiove dhe lehtësitë që do të krijojnë ato për të gjithë hoxhallarët që do të kenë dëshirën dhe vullnetin e mirë për të realizuar ligjëratat dhe emisionet

e tyre. Në këtë përrurim ishin të pranishëm hoxhallarë nga Tirana, Durrësi dhe Shkodra. Ata shprehën kënaqësinë e tyre për mundësinë që do t'u jepet në shfrytëzimin e këtyre studiove të reja. Gjithashtu ata lanë nga një mesazh për studiot e reja, të cilat shumë shpejt do të vihen në funksionim. Studiot e reja të Peace TV janë ndërtuar sipas të gjitha parametrave bashkëkohore dhe me teknologjinë e fundit mediatike.



Analizë / Disa nga sukseset ekonomike të Omer Bin Abdulazizit

Nga: Dr. Ali Xhumuher- REWAHINEH

Omer bin Abdul Azizi nuk kishte shkopin magjik për të shpërndarë mirëqënien në të gjithë umetin islam, por ai arriti të ringjallte ambicet e njerëzve me vepra dhe jo me fjalë. Ai nuk u soll si një njeri i pafuqishëm dhe përtac, dhe as nuk iu bind lakmisë së njerëzve. Në këtë mënyrë umeti u ngrit lart me kontributin e të mëdhenjve dhe të vegjëlve. Ajo që bëri Omer bin Abdul Azizi ishte një zgjim, që mori vull me gjithë forcën dhe masën e saj, dhe që e çoi umetin drejt stabilizimit. Si rrjedhojë disa nga rezultatet më të rëndësishme të kësaj reforme të ndërmarrë nga ai ishin:

1- Rrënjësia e faktorit të besimit në mundësinë e realizimit të mirëqënies ekonomike në nivelin e pushtetarëve dhe në nivelin e qytetarëve. Omer bin Usejdi thotë: "Pasha Allahun, Omeri nuk vdiq derisa dikush të vinte me shumë pasuri dhe të thoshte: "Shpenzoheni aty ku e shihni të arsyeshme" dhe nuk largohej prej aty, por në fund kthehej me gjithë pasurinë e tij, sepse nuk gjente se ku ta jepte lëmoshën, sepse Omeri i kishte pasuruar njerëzit."

2- Elemiminimi i xhepave të varfërisë, derisa njerëzit arritën të mбетeshin të kënaqur. Kur dikush dëshironte të nxirrte zekatin, nuk gjente dike për ta marrë atë."

3- Zgjidhja e deficitit financiar dhe borxhit prej të cilit vuante shteti në kohën e Abdul Melik bin Mervanit, i cili i paguante një takes mbretit të romakëve. Ai u detyrua që të bënte marrëveshje me të, duke i dhënë një takes për ta bindur, që tëmos e luftonte, për shkak se shteti ishte në deficit.

4- Omer bin Abdul Azizi realizoi mirëqënien për shoqërinë islame deri në atëmasë, sa që pasuria i tejkalonte nevojat personale dhe publike. Këtë e tregon edhe një letër që Omer bin Abdul Azizi r.a. ia dërgon

Abdul Hamid bin Abdurrahmanit në Irak: "Jepi njerëzve ndihmën që u takon." Abdul Hamidi ia ktheu letrën: "Unë uadhashë njerëzve ndihmën që meritonin dhe në arkën e shtetit kanë mbetur përsëri para." Omeri i shkroi: "Shiko ata njerëz që kanë marrë borxh jo për t'u tallur dhe as për ta shpërdoruar dhe shlyeja borxhin." Abdul Hamidi ia ktheu: "Unë ua shleva borxhin dhe në arkë kanë mbetur përsëri para." Omeri i shkroi: "Shiko se kush ka mbetur beqar e që dëshiron të martohet dhe nuk ka para. Martoje dhe shlyeja shpenzimet e martesës." Abdul Hamidi ia ktheu: "I martova të gjithë ata që gjeta dhe në arkën e muslimanëve kanë mbetur përsëri para." Omeri i shkroi përsëri: "Shiko ndonjë që ka paguar xhizjen dhe nuk ka mundësi për të punuar tokën e vet dhe jepi borxh, që të ketë mundësi ta punojë, sepse nuk kemi nevojë për të për një ose dy vjet." Imagjino nga të gjitha këto korrespondenca se sa e madhe ishte sasia e parave dhe se sa e lartë ishte mirëqënia, që tejkalon çdo përfytyrim, sesi realizohej kontrolli i të gjitha projekteve të zhvillimit dhe të investimit dhe se si eliminoheshin pengesat që dilnin përpara.

5- Zgjidhja e problemit të borxheve individual dhe shoqërore nga sufiçiti i arkës së shtetit. Omeri r.a. arriti të krijonte një organizëm të veçantë për të ndjekur nga afër çështjet në rang vendor dhe në rang vilajeti. Çdo ditë Omeri r.a. thërriste: "Ku janë borxhlinjtë? Ku janë ata që duan të martohen? Ku janë të vobektit dhe jetimët?"

6- Omeri vendosi një ekip kontrolli të lëvizshëm, që të mbikëqyrte gjendjen e shoqërisë në rang vilajetesh, me shpresën se mos gjente dike që të kishte nevojë për ndihmë. Abdetu bin ebi Lubabe thotë, se Omeri kishte dërguar me të 150 (derhemë) që t'i shpërndante tek fukarenjtë e vendeve

islame. Ai thotë: "Shkova tek Maxhishuni dhe e pyeta. Ai m'u përgjigj: "Sot nuk di të ketë ndonjë nevojtar, sepse Omeri ua ka plotësuar të gjitha."

Kjo ishte drejtësia e tij shoqërore e pashoqe. Nëse njerëzit nuk arrinin të merrnin të drejtat e tyre pasurore, atëherë shteti ua dërgonte ato në qytetet dhe fshatrat ku ata jetonin.

7- Omer bin Abdul Azizi pati sukses në krijimin e bindjes vullnetare ndaj ligjeve të shtetit. Maliku thotë: "Më kanë komunikuar se një punëtor i Omer bin Abdul Azizit i kishte shkruar atij, duke i kujtuar se një burrë nuk pranonte ta jepte zekatin. Omeri i kishte shkruar: "Lëre dhe mos e merr zekatin prej tij bashkë me zekatin e muslimanëve të tjerë." Kjo fjalë kishte mbërritur në veshin e atij burri dhe atij i kishte ardhur rëndë. Pastaj ai e nxorri zekatin e pasurisë së tij. Punëtori i shkroi Omerit këtë që kishte ndodhur dhe Omeri e urdhëroi që ta merrte zekatin prej tij. Një veprim të tillë Omeri ua këshilloi të gjitha zonave kufitare, në mënyrë që të gjithë punëtorët e tij të ndërtonin urat e besimit mes tyre dhe tregtarëve, në mënyrë që të rritej iniciativa personale në zbatimin e rregullave të shtetit. Omeri i shkroi Ruzejkut dhe i tha: "Shiko ata muslimanë që kalojnë andej dhe merr prej tyre vetëm zekatin e pasurive, që janë të dukshme nga mallrat e tregtisë me të cilën merren."

8- Omeri r.a. arriti të shtonte të ardhurat personale deri në atë masë, sa që një shtresë njerëzish, që zotëronin disa pasuri të luksit të përfshiheshin në grupin e përfituesve të zekatis. Esh'hebi thotë: "Më kanë njoftuar se Omer bin Abdul Azizi ka thënë: "Ai që kanë shtëpi, një shërbëtor dhe një kalë le t'i jepet nga zekati."

9- Në vitin e dytë të hilafetit të tij Omeri i ndaloi disa reforma, që i kishte ndërmarrë

për përmirësimin e gjendjes ekonomike gjatë vitit të parë të hilafetit të tij. Ndër to ishte transferta e zekatis drejt vilajeteve, që kishin nevojë për të zgjidhur disa probleme që lindën gjatë vitit të parë të hilafetit të tij. Këtë reformë Omeri e ndaloi në vitin e dytë të hilafetit të tij. Maliku thotë: "Omeri i shkroi dikujt që dorëzonte lëmoshën e tij tek ai, që ta ndante atë më dysh." Esh'hebi thotë: "Nga ky veprim i Omerit kuptuam, se njerëzit nuk kishin në vitin e dytë të njëjtat nevoja si në vitin e parë."


10- Programiqë ndoqi Omeri r.a. për realizimin e reformave ekonomike mund të ndiqet, edhe në ditët e sotme, madje nëse ky program do të zbatohet në kohët e sotme ai do të realizonte një mirëqënie më të madhe sociale dhe do të siguronte sufiçitet të mjaftueshme financiare, sepse kjo kohë ku jetojmë dallohet për elementët e shumtë dhe të shumëllojshme të prodhimit. Gjithashtu është e mundur që të përfitohet nga zhvillimi shkencor bashkohor për të zhvilluar më tej programin që ndoqi Omeri, sepse kushtet bashkohore mund të jenë më të përshtatshme, nëse gjenden njerëz si Omeri, që do ta marrin përsipër këtë program, gjithashtu dhe nëse gjenden njerëz që ta zbatojnë atë ashtu siç e zbatuan njerëzit e Omerit.

Këto janë përfundimet e arritura në fund të një studimi shumë të gjatë mbi reformat ekonomike të Omer Bin Abdulazizit. Ato janë dhënë të përmbledhura nga autori dhe ne po i përcjellim këtu për të shuar kureshtjen e lexuesit tonë. Shkëputur nga libri: "Programi i Omer bin Abdul Azizit në reformën ekonomike".

Përgatiti: G. Plumbi.

Bota Muslimane i kërkon OKB-së ta deklarojë islamofobinë si krim

Nga Ferhan IKBAL



Abu Dabi: Bota mund të jetë një vend një paqshëm për t'u jetuar vetëm kur një qenie njerëzore respekton ndjenjat e tjetrit dhe i lejon atij të zgjedhi lirisht stilin e jetesës, besimin, praktikat dhe fenë e tij pa u bërë i rrezikshëm për asnjërin. Këto këndvështrime janë shprehur nga dijetarët muslimanë, ndërsa theksojnë rëndësinë e tolerancës në një shoqëri, ku si rrjedhojë e një filmi blasfemik anti-islam, i cili lëndoi ndjenjat e muslimanëve dhe ata protestuan fuqimisht kundër tij në të gjithë

globin. Ata thonë se toleranca dhe respekti i feve të tjera do të ndalonte kësi ngjarjesh të dhimbshme.

Ekspertët gjithashtu kanë theksuar se çfarë kuptimi ka realisht fjala "Liri e Shprehjes". Liria e shprehjes nuk lejon ndokënd të sulmojë çdolloj feje apo personat e shenjtë të ndonjë feje në veçanti. Nëse ndokush vepron kështu ai do të ndizte një situatë, e cila do të bëhej e pakontrollueshme, ashtu siç ndodhi në botën muslimane pas daljes në qarkullim të filmit anti-islam. Gjatë protestave kundër këtij filmi të neveritshëm të bërë nga disa islamofobë të vonuar mendërisht një dyzinë njerëzish u vranë në Libi, gjithashtu u vra edhe ambasadori amerikan nga turma e tërbuar. Dijetarët muslimanë e kanë sqaruar, se të bësh karikatura dhe filma të personaliteteve të shenjta është krejtësisht e ndaluar (haram) në Islam. Dhe nëse ndokush përpigjet të tallet me personalitetet e shenjta të Islamit për Muslimanët është tejet e papranueshme, sepse ata e duan Profetin Muhamed a.s. më tepër se sa këdo tjetër në botë, më tepër se sa të afërmit dhe fëmijët e tyre. Ata thonë se Muslimanët i respektojnë të gjitha fetë dhe jo-Muslimanët gjithashtu e respektojnë Islamit dhe Profetin Muhamed a.s., por ka disa elemente që e shqetësojnë harmoninë ndërfaqetare ndërmjet

Muslimanëve dhe popujve të feve të tjera. Ata i kanë kërkuar Kombeve të Bashkuara të nxjerrin një vendim për respektimin e të gjitha feve dhe qeveritë gjegejëse t'i dënojnë këta keqbërës. Islamofobia të konsiderohet krim dhe fajtorët të trajtohen ashpërsisht. Ndërkaq Kombet e Bashkuara me kërkesën e Organizatës për Bashkëpunim Islam do të debatojnë edhe një herë për ligjet blasfemike, që potencialisht mund të kriminalizojnë për fyerje fetare. Sekretari i OKB-së Ban Ki Mun javën e fundit tha: Ne po jetojmë përgjatë një periudhe paqetësie. Ne gjithashtu po shohim incidente intolerance dhe urrejtje, që më pas shfrytëzohen nga të tjerët. Zërat për moderacion dhe qetësi nevojitet ta bëjnë veten që të dëgjohen më shumë në këto kohë. Nevojitet që ne të gjithë të flasim në favor të respektit të ndërsjellë dhe të kuptojmë vlerat dhe besimet e të tjerëve,- shtoi ai.

Suzan Bruks Thisëllthuejt një bashkëpunëtorë e vjetër e Center for American Progress vuri në dukje në Uashington Post se "që nga viti 1999 56 kombet e Organizatës për Bashkëpunim Islam kanë kërkuar të përfshijnë çështjen e fyerjeve fetare në rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së". Përfundimi dhe organizatat e të drejtave të njeriut zakonisht i kanë kundërshtuar ligje të

tilla, duke u bazuar në atë se do të kufizojnë lirinë e shprehjes. Por këtë vit pas një videoje anti-islame, prej së cilës shpërthyen rebelime vdekjeprurëse nëpër botë gjendja globale ka ndryshuar krejtësisht nga viti i shkuar.

Kurtnej Radsh menaxher i programit për Global Freedom of Expression Campaign thotë për Spokesman Review, se "Unë pres që ne do të bëjmë mbropa atje ku ishim dy vite më parë." Po ashtu ajo shton: "Të drejtat e njeriut nuk janë për të mbrojtur fetë; të drejtat e njeriut janë për të mbrojtur njerëzit. Kush do të jetë ai vendim-marrës që do të vendosë se çfarë është blasfemia?"

Kryeministri turk Rexhep Tajip Erdogan thotë se ai do t'i drejtohet për këtë çështje Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork kur kjo do të mbledhet. Ai tha: "Unë jam kryeministri i një kombi që në pjesën më të madhe është musliman, dhe që e ka deklaruar anti-semitizmin krim kundër njerëzimit. Por Përfundimi nuk e ka njohur akoma Islamofobinë si krim kundër njerëzimit. Ato e kanë inkurajuar atë," - përfundoi ai.

<http://www.islamonline.com/news/articles/122/Rights-of-Non-Muslims-in-Islam.html>

Rënia e bllokut komunist dhe elita boshnjake

Nga Faik MIFTARI

Viti 1989 do të mbetet i shënuar në historinë më të re botërore si vit i shembjes së murit të Berlinit, pas të cilit nisi edhe përfundimi i sistemit socialist (komunist) në Evropën juglindore dhe si rrjedhojë e saj edhe shpërbërja e ish tre federatave artificiale, Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë si dhe Çekoslovakisë. Dekada e fundit e shekullit XX, do të mbahet mend edhe për luftërat e përgjakshme si pasojë e këtyre shpërbërjeve të ish federatave, më pak në ish Bashkimin Sovjetik, e më shumë në ish Jugosllavi, ndërsa aspak në ish Çekoslovakia, e në të cilat përveç të tjerave u përfshinë edhe popujt muslimanë sikur boshnjakët dhe shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Këtu do të cek një detaj të veçantë, pas fillimit të rrënjës së sistemit komunist, në nëntor të vitit 1990 u mbajt në Sarajevë kongresi, kuvendi apo takimi i parë i rinisë muslimane nga tërë hapësira e ish-Jugosllavisë, i cili ishte i pari, por edhe i fundit, që u mbajt, dhe më pas pasoi në vitin 1991 edhe fillimi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, që nisi nga Sllovenia e Kroacia, vazhdoi me Bosnjën dhe Maqedoninë dhe përfundoi me Malin e Zi dhe Kosovën.

Gjatë ditëve që u mbajt kuvendi apo takimi i rinisë muslimane nga hapësira e ish-Jugosllavisë në amfiteatër të rinj muslimanë mbanin fjalime, ligjërime, diskutonin, për problemet dhe hallet e tyre që i kishin nga hapësira nga vinin, pas së cilës vazhdonin me takime, njoftime dhe shoqërime të përbashkëta, si dhe në faljen e përbashkët të namazit në xhaminë e Beut. Ishte një kënaqësi e rrallë, kur i shihje të gjithë së bashku të falnin namazin me vetëm një rregull dhe rend të caktuar, atë të drejtimit juridik hanefit, i cili gjer në atë kohë ishte i vetmi i pranishëm në këto hapësira, që nga pranimit i Islamit në këto troje e gjer në vitin 1992. I vetmi dallim në mes të rinjve musliman ishte të thuash në konceptin e ndarjes gjeografike, veri –jug, gjersa të rinj musliman nga Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja ishin në një shkallë shumë më të lartë të zhvillimit ekonomik, shoqëror e mbi të gjitha të nivelit studiues arsimor, duke marrë për bazë, fjalën e parë hyjnore të shpallur në Kuran "Ikre" që do të thotë: "Lexo, mëso, studio", të cilin e kishin marrë si moto të tyre për studimin dhe ngritjen e vetëdijes arsimore, studiuese, shkencore në dallim nga të rinjtë muslimanë, që vinin nga Sanxhaku, Kosova dhe Maqedonia, të cilët përkundër tyre e kishin ruajtur më tepër traditën e kultivimit dhe ushtrimit të traditave të fesë Islame.

Se sa ishin të rinjtë musliman boshnjak të ngritur në këtë stad arsimit dhe edukimi në përgjithësi, si dhe të përkatësive islame në veçanti, si shembull do të cek një poezi që e kishte thurur poetja boshnjake Xhemila Zekiç, e që ka lënë mbresa të jashtëzakonshme te të rinjtë pjesëmarrës në këto takime rimore të mbajtura për herë të parë, e që dolën të jenë edhe për herë të fundit në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Poezinë do ta prezantojmë me përkthimin e saj në shqipë. Poezia përkthehet, por ajo pas përkthimit, e humb stilin, rimimin, bukurinë të cilin e ka sjuar poeti apo poetja në gjuhën që e flet.

HIMN ISLAMIT

*Gjersa Toka me Hënë
Rreth Diellit rrotullohet
Pishtarin Islam përgjithmonë
Asnjëri nuk mund ta mpjijë.*

*Lindje, Perëndim, Jug e Veri
Allah, Allah, klith e flet
Nga miliona minare
Ezani i Resultit buçet
Katërbëdhjetë shekuj
Emri i Resultit lavdërohet
Dhe se Ai do të lavdërohet
Gjersa të ekzistojë universi i kaltër.*

*Selam alejkum me
Dashuri zemrat tona i kallë
Kurrë nuk do të vdesin
Idealet tona Islame.*

*Në buzët tona Allah, Allah,
Përherë do të shqiptohet
Kurani Fisnik është udhëzues i
Fesë sonë të lartësuar.*

*Gjersa Toka me Hënë
Rreth Diellit rrotullohet
Pishtarin Islam përgjithmonë
Asnjëri nuk mund ta mpjijë.*

Nuk kaloi as një vit nga këto takime pasoi shpallja e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë dhe shpërthimi i luftës së shkurtër në Slloveni, pas së cilës do të vazhdojë edhe në Kroaci. Në prill të vitit 1992 pasoi edhe shpallja e pavarësisë së Bosnjës e Hercegovinës, pas së cilës shpërtheu lufta më e përgjakshme në tërë hapësirën e ish-Jugosllavisë, ku agresori serb kreu edhe gjenocidin e paparë gjer tani në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore.

Boshnjakët pas luftës së paparë heroike të tyre trevjeçare e gjysmë, arritën ta ruajnë Bosnjën e Hercegovinë në kufijtë e saj ekzistues të jashtëm dhe ndërkombehtarisht të pranuar, dhe se nuk u realizua klithja e Radovan Karaxhiçit, ish-liderit serb në Bosnjë, se "Bosnja nuk do të ekzistojë dhe se populli musliman (boshnjak) do të zhdukej", por u realizua thënia e Alija Izetbegoviçit, ish liderit dhe kryetar i Bosnjës, se "Bosnja do të ekzistojë dhe se populli musliman (boshnjak) do të mbijetojë".

Edhe pse të rrethuar plotësisht nga të gjitha anët dhe të ballafaquar në luftë me serbët gjatë tërë kohës së luftës në njërën anë, një kohë të shkurtër edhe me kroatët në anën tjetër, si dhe me tradhtarin boshnjak Fikret Abdiç, i cili u vu në shërbim të agresorit serb dhe kroat dhe me bashkëmendimtarët e vet luftuan kundër vëllezërve të vet, boshnjakët treguan një pjekuri politike të jashtëzakonshme, një strategji ushtarake të mirëfilltë, një diplomaci futuruese, duke i përdorur të gjitha kanalet diplomatike, si në Perëndim ashtu edhe në Lindje, me një armatim të lehtë që i kishin në dorë, por me një strukturë udhëheqëse ushtarake profesionale të arsimuar dhe të trashëguar nga ish-Armata Popullore Jugosllave



arritën që gjer në fund të luftës të krijonin një armatë të tërë të duhur, e cila po të mos ishte embargoja e armëve e vënë nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së do të arrinin suksese shumë më të madh. Por edhe kështu me duart e lidhura nga embargoja e armëve, gjatë gjithë kohës arritën të ruajnë një të tretën e territorit të Bosnjës, aty ku ishin me numër shumicë dhe ishin të përgatitur mirë për luftë, ashtu që në këto pesë rajone, në Sarajevë, Tuzëll, Zenicë, Mostar, Bihaç, assesi nuk kanë mundur serbët të depërtojnë e lere më të okupojnë këto zona.

Këtë fenomen të Bosnjës më së miri e ka përshkruar Juan Goytisolo me thënien: "Tragjedia e Bosnjës paraqet një mjet për njohjen e mundësive të llojit njerëzor, si atyre më të ndritura ashtu edhe atyre më të këqija". Suksesi i boshnjakëve për ruajtjen e etnosit të tyre boshnjak, si dhe krijimit të shtetit të Bosnjës e Hercegovinës qëndron në atë se atë nuk kanë pasur alternativë tjetër në mes zgjedhjes, që boshnjakët dhe Bosnja të mbeten pjesë e krijimit të Serbisë së Madhe dhe të pushtetit të Karaxhiçit dhe Millosheviçit, që automatikisht do të thoshte pranimit i robërisë nën tutelën serbe, e cila do të ishte më e keqe se lufta dhe kundërvënies. Ata zgjedhën që t'i kundërvihen luftës së shpallur nga agresori serbo-madh, dhe pas shumë vuajtjeve, torturave, dhunimeve, vrasjeve, shkatërrimeve, plagosjeve, dhe veprimtari të duhur dhe me kohë të faktorëve politik vendimmarrës botëror arritën që më në fund të mbijetojnë dhe të shpëtojnë nga robëria dhe shkatërrimi total.

Me rastin e vizitës në Sarajevë në vitin 2001 takova edhe zotëri Mehmedalija Haxhiçin, i cili në atë kohë ishte myfti i Sarajevës dhe më pas u bë edhe ambasador fuqplotë i Bosnjës e Hercegovinës në Rijad të Arabisë Saudite, i cili gjatë gjithë kohës së luftës ka qëndruar dhe kontribuar në mbrojtjen e Sarajevës, gjatë rrethimit të saj të plotë rreth 1300 ditë. Gjatë kësaj kohe ranë dëshmorë vetëm në kryeqytetin e Sarajevës rreth 10.000 vetë dhe u plagosën mbi 50.000 njerëz. Pyetjes time për të më sqaruar fenomenin e Sarajevës, se si ka mundur të shpëtojë pa rënë në duart e serbëve ai m'u përgjigj me këto fjalë: "Ne si muslimanë besimtarë që jemi dhe që besojmë në Allahun Fuqplotë themi se me rastin e Sarajevës ka ndodhur muxhize (mrekulli) nga Zoti, që na ka

mbrojtur dhe shpëtuar për të mos rënë kryeqyteti ynë në duart e çetnikëve serb. Me rastin e fillimit të agresionit serb në Bosnjë ka qëlluar festa e Fitër Bajramit, dhe atë natë në vigjilje të ditës së Bajramit, deri vonë e tërë Sarajeva ka buçitur nga breshërimat e pandërprerë të rafalëve të pushkëve, kallashëve dhe mitralozave që i kishim në duar, e kështu ka vazhduar gjer në agim, ne do të mbeteshim pa plumba, dhe vetëm me armë të thata në duart tona dhe me gishtin në gojë. Serbët që e kishin rrethuar Sarajevën dhe që ishin rreth e rrotull saj, përveç malit të Igmanit, e cila ishte e vetmja maje në duart tona, e kishin komentuar këtë me fjalët: -Of! Of! Of! sa shumë armatim paskan muslimanët, pasi tërë natën po festojnë Bajramin duke gjuajtur pandërprerë rafale në qiell prej gëzimit, po ku me ditë se çfarë armatimi e kanë përgatitur për të na pritur neve?!..." Ashtu që gjatë tërë kohës së rrethimit të Sarajevës, vetëm e kanë bombarduar me qindra e mijëra herë me topa dhe tanksa të kalibrave nga më të ndryshme gjatë 1300 ditëve të rrethimit të Sarajevës, por nuk kanë tentuar të hynin brenda saj, edhe disa tentime të vogla që i kanë bërë ju kanë dështuar nga mbrojtja e fortë e jona, e neve në duart tona përveç armatimit të lehtë që kemi pasur, kemi pas gjatë gjithë kohës edhe lutjet tona dhe me ndihmën e Allahut Fuqplotë arritëm të mbijetojmë dhe shpëtojmë nga kthetrat serbe".

Por suksesi përfundimtar qëndroi në atë se në krye të udhëheqjes së rezistencës së popullit boshnjak dhe luftës së zhvilluar ka qenë elita politike, fetare dhe ushtarake e boshnjakëve, në krye të së cilës qëndronte Alia Izetbegoviçi dhe në vetëdijen e kësaj elite ishte besimi i thellë dhe i patundur ndaj Zotit të Madhëruar, dhe se e dinte që duart e tyre ishte vetëm mundësia e punës së pandërprerë të bërë gjatë tërë luftës në mbrojtjen e popullit boshnjak dhe civilizimit islam që i përkiste, dhe se kjo përpjekje ishte një sprovë me të cilin u ballafaqua dhe së fundi kjo elitë doli faqebardhë.

Që kjo rezultoi me sukses ndërlihet edhe me thënien e njohur e Alia Izetbegoviçit: "E jona është të punojmë pandërprerë. Zgjidhja nuk është në duart tona. Jam i kënaqur që besoj se zgjidhja është në duart e Zotit", me poezinë e poetes boshnjake Xhemile Zekiçit "Himn Islamit".

Udhëzuesi i haxhiut. Çfarë duhet të bëjë haxhiu gjatë ditëve të Haxhit? L.H.SH.

Dita	Haxhiu që kryen vetëm Haxhin (Mufrid)	Haxhiu që kryen Haxhin dhe Umren pa e hequr Ihramin (Mukrin)	Haxhiu që kryen Haxhin dhe Umren duke e hequr Ihramin (Mutemeti)
Çfarë bën haxhiu para ditës 8 Dhul Hixheh	1-Vesh Ihramin nga Mikati dhe bën nijetin duke thënë: "Tu përgjigja Ty me Haxh o Allah." 2- Bën tafavin e mirëseardhjes në Qabe. 3- Bën Sa'jin midis Safasë dhe Mervasë, nëse nuk e bën, ai duhet ta kryejë atë pas tavafit të Haxhit (Ifada) dhe qëndron me Ihram deri në ditën e Kurbanit. Ky haxh nuk ka detyrim kurbanin.	1-Vesh Ihramin nga Mikati dhe bën nijet duke thënë: "Tu përgjigja Ty Allah me Haxh dhe Umre." 2- Bën tafavin e mirëseardhjes. 3- Bën sa'jin midis Safasë dhe Mervasë. Lejohet që ta vonojë atë pas tavafit të Haxhit (Ifada). Ai qëndron me Ihram deri në ditën e therjes.	1-Vesh Ihramin nga Mikati dhe bën nijet duke thënë: "Tu përgjigja Ty Allah me Umre, duke u liru deri në Haxh." 2- Bën tafavin e mirëseardhjes (pra të Umres) 3- Bën sa'jin midis Safasë dhe Mervasë. 4- Shkurton ose rruan flokët. 5- Heq Ihramin dhe qëndron pa të deri në ditën 8 Dhul Hixhe.
Dita 8 Dhul Hixheh	Haxhiu shkon në Mina (Fal atje 5 vaktet, duke i shkurtuar, por pa i bashkuar namazet me katër rekatë).	Haxhiu shkon në Mina (Fal atje 5 vaktet, duke i shkurtuar, por pa i bashkuar namazet me katër rekatë).	Pasi të ketë veshur Ihramin nga vendqëndrimi i tij shkon në Mina dhe, fal atje 5 vaktet, duke i shkurtuar, por pa i bashkuar namazet me katër rekatë.
Dita 9 Dhul Hixheh, dita e Arafatit	1- Haxhiu drejtohet për në Arafat pas lindjes së diellit (fal atje drekën dhe ikandinë në kohën më të parë, me një ezan dhe dy ikamete, duke i shkurtuar dhe bashkuar). Është prej sunetit që haxhiu të shpeshtojë përmendjen e Allahut xh.sh, të lexojë Kuran dhe të lutet ditën e Arafatit. Suneti e do që ai të drejtohet nga Kibla dhe jo nga mali, të ngrrejë duart lart gjatë dua'së, ashtu siç ka bërë i dërguari i Allahut a.s. Agjërimi ditën e Arafatit është i papëlqyeshëm. Haxhiu nuk duhet të qëndrojë jashtë tabelave treguese të Arafatit në vende që nuk janë pjesë e tij, dhe as nuk është e nevojshme të ngjitet në malin e Arafatit. 2- Haxhiu drejtohet për në Muzdelife, pas perëndimit të diellit. 3- Fal Akshamin dhe Jacinë kur të mbërrijë në Muzdelife, duke i shkurtuar dhe bashkuar namazet (bashkimi i vonuar) me një ezan dhe dy ikamete. 4- Merr 7 guralecë për të goditur gurin (shtyllën) e madh, por edhe nëse i merr në Mina, kjo lejohet. Guralecët duhet të kenë madhësinë e bizeles. 5- Haxhiu e kalon natën në Muzdelife, fal aty namazin e Sabahut dhe shpeshon dhikrin dhe lutjet pas faljes. Parapëlqehet që haxhiut të qëndrojë tek Mesh'ari Haram (vendi i xhamisë) dhe të shpeshtojë lutjet, derisa të zbardhet paksa para lindjes së diellit. Lejohet që të pafuqishmit të largohen nga Muzdelifeja para mesnatës (pas perëndimit të hënës).	1- Goditja me gurë e gurit të madh, 7 herë. 2- Therja e Kurbanit. 3-Rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre, kurse gruaja shkurton majat e flokëve. 4- Heqja e Ihramit dhe veshja e rrobave. 5- Tavafi i Haxhit (ifada) dhe bërja e Sa'jit bashkë me të, nëse nuk e ka bërë sajnin më parë.	1- Goditja me gurë e gurit të madh, 7 herë. 2- Therja e Kurbanit që vazhdon deri në perëndim të diellit ditën e 13-të. 3-Rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre. 4- Heqja e Ihramit dhe veshja e rrobave. 5- Tavafi i Haxhit (ifada) dhe bërja e Sa'jit bashkë me të, nëse nuk e ka bërë sajnin më parë.
10 Dhul Hixheh	1- Goditja me gurë e gurit të madh, 7 herë. 2-Rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre. 3- Heqja e Ihramit dhe veshja e rrobave. 4- Tavafi i Haxhit (ifada). 5- Lejohet që të shtyhet tavafi i Haxhit deri në ditën e 11, 12 ose të bëhet bashkë me tavafin e Lamtumirës. 6- Bërja e Sa'jit, nëse nuk e ka bërë sajnin më parë.	1- Goditja me gurë e gurit të madh, 7 herë. 2- Therja e Kurbanit. 3-Rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre, kurse gruaja shkurton majat e flokëve. 4- Heqja e Ihramit dhe veshja e rrobave. 5- Tavafi i Haxhit (ifada) dhe bërja e Sa'jit bashkë me të, nëse nuk e ka bërë sajnin më parë.	1- Goditja me gurë e gurit të madh, 7 herë. 2- Therja e Kurbanit që vazhdon deri në perëndim të diellit ditën e 13-të. 3-Rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre. 4- Heqja e Ihramit dhe veshja e rrobave. 5- Tavafi i Haxhit (ifada) dhe bërja e Sa'jit bashkë me të, nëse nuk e ka bërë sajnin më parë.
11 Dhul Hixheh	1- Qëndrimi në Mina natën e 11- të (obligim-vaxhib) 2- Goditja me gurë e tri shtyllave pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen dhe të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir (Allahu Ekber) para çdo goditje dhe bën lutje pas goditjes së të voglës dhe të mesmes.	1- Qëndrimi në Mina natën e 11- të (obligim) 2-Hedhja e gurëve tek tri shtyllat pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen, e më pas të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir para çdo goditje dhe bën dua' pas goditjes së të voglës dhe të mesmes. Lejohet që haxhiu të shpejtojë dhe të largohet nga Minaja drejt Mekës para perëndimit të diellit, pastaj të bëjë tavafin e Lamtumirës, e nëse dëshiron të qëndrojë ... (vazhdon në ditën e 13-të)	1- Qëndrimi në Mina natën e 11- të (obligim-vaxhib) 2- Goditja me gurë e tri shtyllave pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen dhe të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir para çdo goditje dhe bën dua' pas goditjes së të voglës dhe të mesmes. 2- Largimi nga Minaja për në Mekë dhe bërja e tavafit të Lamtumirës (obligim-vaxhib), i cili nëse lihet kërkon shpagim me therje kurbanit, përjashtohet gruaja me menstruacione dhe lehona. Pas këtij tavafi bëhet largimi nga Meka
12 Dhul Hixheh	1- Qëndrimi në Mina natën e 12- të (obligim) 2-Hedhja e gurëve tek tri shtyllat pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen, e më pas të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir para çdo goditje dhe bën dua' pas goditjes së të voglës dhe të mesmes. Lejohet që haxhiu të shpejtojë dhe të largohet nga Minaja drejt Mekës para perëndimit të diellit, pastaj të bëjë tavafin e Lamtumirës, e nëse dëshiron të qëndrojë ... (vazhdon në ditën e 13-të)	1- Hedhja e gurëve tek tri shtyllat pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen, e më pas të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir para çdo goditje dhe bën dua' pas goditjes së të voglës dhe të mesmes. 2- Largimi nga Minaja për në Mekë dhe bërja e tavafit të Lamtumirës (obligim-vaxhib), i cili nëse lihet kërkon shpagim me therje kurbanit, përjashtohet gruaja me menstruacione dhe lehona. Pas këtij tavafi bëhet largimi nga Meka	
13 Dhul Hixheh	1-Hedhja e gurëve tek tri shtyllat pas mesditës, duke filluar me të voglën, të mesmen, e më pas të madhen (7 guralecë për secilën), duke bërë tekbir para çdo goditje dhe bën dua' pas goditjes së të voglës dhe të mesmes. 2- Largimi nga Minaja për në Mekë dhe bërja e tavafit të Lamtumirës (obligim-vaxhib), i cili nëse lihet kërkon shpagim me therje kurbanit, përjashtohet gruaja me menstruacione dhe lehona. Pas këtij tavafi bëhet largimi nga Meka		

Pas lejimit të parë (lirimi i parë), haxhiut i lejohet gjithçka përveç marrëdhënieve intime, kurse bërja e tavafit të Haxhit (lirimi i dytë) i lejon atij gjithçka, kjo nëse e ka bërë më parë Sa'jin në rastin e haxhiut Mufrid ose Mukrin, kurse haxhiu Mutemeti, duhet që më parë të bëjë Sa'jin para se të heqë përfundimisht Ihramin.

Shtyllat e Haxhit	Obligimet e Haxhit	Shejh Abdulaziz ibn Baz, i pyetur në lidhje me gjykimin e disa veprimeve në haxh, është përgjigjur: "Fërkimi pas Mekamit të Ibrahimit, me muret e Qabes ose me mbulesën e saj, janë vepra të paligjshme. Për to nuk ka asnjë bazë në Sheriatin Islam. Gjëra të tilla nuk i ka vepruar i Dërguari i Allahut a.s..Ai ka puthur dhe ka prekur Gurin e Zi, dhe ka prekur muret e Qabes nga brenda. Kur ka hyrë brenda në Qabe, i Dërguari i Allahut a.s. ka ngjitur kraharorin, krahët dhe faqen e tij në muret e saj. Ai ka bërë tekbire dhe është lutur në anët e saj. Në bazë të transmetimeve të sakta, gjëra të tilla ai nuk i ka vepruar jashtë Qabes, edhe pse në lidhje me mbështetjen e kraharorit, të duarve dhe të faqes midis Gurit të Zi dhe portës së Qabes nga ana e jashtme ka një transmetim të dyshimtë ¹ . Megjithatë, një vepër të tillë midis Gurit të Zi dhe portës së Qabes e kanë vepruar disa prej sahabeve, kështu që nuk ka problem nëse dikush e kryen atë. Puthja e Gurit të Zi është sunet, ndërsa mbështetja dhe kapja pas mbulesës dhe mureve të Qabes është një vepër e pabazë, e cila nuk duhet vepruar, sepse atë nuk e ka vepruar i Dërguari i Allahut a.s. dhe sahabet. Prekja, puthja dhe fërkimi i Mekami Ibrahimit janë gjithashtu vepra të pabaza, të cilat nuk duhen vepruar, sepse konsiderohen bidate të shpikura prej njerëzve. Gjithashtu lutja e Qabes dhe kërkimi i begatisë prej saj, nuk lejohet, sepse kjo është lutje, e cila i drejtohet dikujt tjetri përveç Allahut. Kush kërkon prej Qabes t'i shërojë të sëmurin, apo fërkohet tek Mekami Ibrahimit, duke shpresuar se sjell shërim, ka kryer një vepër të paligjshme dhe ka rënë në shirk, idhujtari. Allahu na mbroftë nga të tilla vepra
1- Ihrami (nijeti), qëllimi për të hyrë në rite. 2- Qëndrimi në Arafat 3- Tavafi i Haxhit (ifade) 4- Sa'ji mes Safasë dhe Mervasë	1- Ihrami nga Mikati 2 - Qëndrimi në Arafat deri natën 3- Qëndrimi në Muzdelife natën e Kurbanit 4- Qëndrimi netëve në Mina 5- Hedhja e gurëve tek shtyllat, ditët e Teshrikut 6- Tavafi i Lamtumirës 7- Qethja ose rruajtja e kokës	
Ai që lë diçka prej këtyre shtyllave nuk e ka bërë Haxhin derisa t'i plotësojë ato.	Ai që lë diçka prej këtyre obligimeve detyrohet të therë kurban në Mekë dhe ta ndajë atë për të varfrit, pa ngrënë asgjë për vete dhe Haxhi i tij është i saktë.	
Sunetet e Haxhit: Ai që lë pa bërë diçka prej tyre nuk ka asnjë gjynah apo shpagim. 1- Larja para veshjes së Ihramit 2- Ihrami i bardhë i përbërë nga një veshje e sipërme dhe e poshtme për burrat. 3- Telbija dhe ngritja e zërit gjatë këndimit të saj. (Lebejke Allahume lebejke, lebejke la sherike leke lebejke, inel hamde ue niamete leke uel mulk la sherike leke) 4- Qëndrimi në Mina natën e Arafatit. 5- Puthja e gurit të zi. 6- Zhveshja e shpatullës së djathtë nga Ihrami (vetëm gjatë tavafit të mirëseardhjes dhe sa'jit dhe jo gjatë gjithë kohës) 7- Rendja (shpejtimi i të ecurit në tri xhirot e para të tavafit të mirëseardhjes dhe sa'jit)		
Nëntë gjëra nga të cilat duhet bërë kujdes me Ihramin: 1- Rruajtja e qimeve 2- Preerja e thonjve 3- Mbulimi i kokës së burrit me gjëra që ngjisin pas koke. 4- Veshja e ndërresave apo çorapeve, për burrat 5- Përdorimi i parfumeve. Ai që i bën këto pesë gjëra në harresë ose nga padija është i justifikuar, e kush i bën me qëllim, ai duhet të përzgjedhë këto tri shpagime: Agjërimin e tri ditëve, të ushqyerin e 6 të varfërve ose therjen e një deleje. 6- Gjethia e kafshëve ose dhënia e ndihmës për këtë, apo largimi i gjahut nga vendi i tij. Për vrasjen e gjahut me qëllim, shpaguhet me diçka të barasvlershme 7- Marrëdhënia me gruan me epsh pa kryer aktin futjes. Nëse njeriu bëhet khunub, haxhi i tij nuk priset, por duhet të bëjë kurban si shpagim 8- Akti i martesës, por nuk ka asnjë shpagim 9- Marrëdhëniet me gruan në organe. Nëse kjo ndodh para lejimit të parë (lirimit), haxhi i tij priset, por duhet plotësojë pjesën e mbetur, obligohet ta plotësojë atë vitin tjetër dhe duhet të therë kurban në Mekë, por nëse kjo ndodh pas lejimit (lirimit) të parë, haxhi i tij është i saktë dhe duhet të therë një dele.		
Kurbanit: Vendi i therjes: Minaja, lejohet në Mekë dhe në pjesën e mbetur të Haremit të Mekës. Lloji: Deveja, lopa dhe bagëtia e imët (dele, dash dhe dhi). Delja dhe dashi duhet të kenë mbushur 6 muaj dhe dhia një vit, lopa duhet të ketë mbushur dy vjet dhe deveja 5 vjet. Të gjitha mjaftojnë për një person të vetëm, kurse deveja dhe lopa mjaftojnë për 7 persona. Ai që nuk ka mundësi për kurban, agjëron 3 ditë në Haxh dhe 7 ditë kur kthehet në familjen e tij. Kurbanit nuk pranohet nëse është i verbër, brinjë thyer, i sëmurë, i pafuqishëm, me bri të thyer apo me vesh të këputur në pjesën e tij më të madhe.		

A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë

Cel: 0672812607 / 0672821589